

Mos vallë fëmija im ndihet keq sepse nuk di greqisht?

Në kontaktin e tij të fundit me kopshtin fëmija do të përballet pa dyshim me një vështirësi tjetër nëse nuk e njih gjuhën. Megjithatë do ta kalojë shumë shpejt. Në kopësht fëmijët komunikojnë më shumë me shprehjet e fytyrës dhe të trupit dhe më pak me fjalë. Gjithashtu shumica e aktiviteteve të programit kanë formën e lojës (lëvizëse, muzikore, teatrale, etj) dhe nuk kërkojnë përdorimin e fjalës. Kështu, të gjithë fëmijët ndihen mirë dhe mund të marrin pjesë, pamvarësisht sa mirë e flasin gjuhën.



A duhet të flasim në shtëpi greqisht që fëmija ta mësojë më shpejt gjuhën?

Në asnjë mënyrë! Është shumë e rëndësishme të flisni me fëmijën gjuhën tuaj amtare. Studimet dhe eksperiencat arsimore, kanë provuar se sa më mirë mëson një fëmijë gjuhën e tij amtare, aq më mirë do të mësojë një gjuhë të dytë, në rastin konkret greqishten.



Enti zbatues

POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dygjuhësinë dhe Shumëkulturën në Arsim dhe në Shoqëri



www.polydromo.gr
polydromo@polydromo.gr

Autore teksti

Koralia Agapitu, Athina Goci, Marianthi Kalafati, Fotini

Kostudhi, mësuese të arsimit fillor.

Aleksandra Andhrusu, Pedagoge Asistente e Metodologjisë Didaktike, Departamenti i Arsimit dhe i Edukimit në Moshën Parashkollore.

Koordinatorë të programit

Birbili Maria – Cokalidhu Rula

Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe të Arsimit Parashkollor
Universiteti Aristoteli Selanik

Email: mmpirmpi@nured.auth.gr
tsokalid@nured.auth.gr

Website: www.polydromo.gr/dialogos

Përkthyes

Valbona Hystuna

Përpunuan tekstin

Evi Marku

Me mbështetjen e



Pse të ndjekë fëmija kopshtin parashkollor?

Informohem rreth arsimit



Eksperienat e fëmijëve në moshën parashkollore janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e tyre të mëvonshëm. Në një ambient didaktik të përshtatshëm të organizuar dhe nëpërmjet lojës, fëmija do të zotërojë bazat mbi të cilat do të bazohet ecuria e tij shkollore.



A ndjek kopshti (parashkollor) një program të posaçëm?

Të gjitha kopshtet ndjekin parimet dhe udhëzimet e Programit Analitik. Ky program, propozohet nga Ministria e Arsimit dhe përcakton objektivat e përgjithshme dhe qëllimet që duam të arrijmë. Thëkson procedurën dhe jo rezultatin. Është elastik dhe përshkruan kuadrin në të cilin do të krijohen kushtet për arritjen e qëllimeve të tij. Nuk ka material të posaçëm mësimor të cilin duhet patjetër ta zbatosh tek të gjithë fëmijët në mënyrë që të kalojnë në nivelin tjetër arsimor. Aktivitetet, nganjëherë lindin nga kërkesat e fëmijëve dhe nganjëherë propozohen nga mësuesit/et. Planifikohen në mënyrë të tillë që të plotësojnë nevojat, interesat dhe aftësitë e të gjithë fëmijëve të së njëjtit grup.

«Fëmijët në kopshtin parashkollor vazhdimisht luajnë dhe vizatojnë»

Shpesh dëgjohet mendimi se «fëmijët në kopsht vetëm luajnë dhe vizatojnë» duke shprehur shqetësimin se në këtë mënyrë nuk mësojnë aq shumë sa të parapregatiten për në shkollën fillore. Por, në fakt, fëmijët mësojnë kryesisht nëpërmjet lojës dhe zhvillohen nëpërmjet aktiviteteve krijuese siç është vizatimi, muzika, teatri, etj. Në kopsht fëmijët shprehen dhe komunikojnë më shumë nëpërmjet vizatimit, punëve të dorës dhe teatrit, sesa nëpërmjet bashkëbisedimit midis tyre. Edhe pse fjala e tyre nuk është e formuar plotësisht dhe e qartë, të gjithë fëmijët mund të shprehen nëpërmjet artit. Këto aktivitete janë shumë të rëndësishme dhe përbëjnë makinerinë bazë që udhëheq fëmijën drejt të mësuarit.

Çfarë mësojnë fëmijët në kopshtin parashkollor?

- Të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë me fëmijë e të rritur.
 - Të shprehin mendimin e tyre, të faktojnë me fakte logjike mendimin e tyre.
 - Të dëgjojnë me kujdes dhe të respektojnë mendimin e ndryshëm nga ai i tyre.
 - Të zbulojnë aftësitë e tyre.
 - Të fitojnë vetbesim.
 - Të ndër marrin iniciativa.
 - Të propozojnë aktivitetet që u interesojnë.
- Shumica e aktiviteteve në kopshtin parashkollor kanë formën e lojës me qëllim të mobilizojnë pjesëmarrjen aktive dhe interesin e fëmijëve për të mësuar. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve fëmijët:
- Zhvillojnë aftësi.
 - Kultivojnë gjuhën, aritmetikën dhe zhvillojnë dijet e tyre rreth ambientit (natyror dhe shoqëror).
 - Zhvillojnë fantazinë dhe krijimtarinë e tyre nëpërmjet vizatimit, ndërtimit të objekteve, muzikës dhe artit të teatrit.
 - Vijnë në kontakt me teknologjinë moderne dhe kompjuterat.

Shëtitje edukative – lidhja me komunitetin e gjerë

Pjesë të jetës shkollore përbëjnë shëtitjet edukative si dhe çdo lloj shfaqjeje dhe aktiviteti të cilat janë pjesë e programit që ndjek kopshti. Shëtitjet edukative sjellin fëmijën në kontakt me realitetin aktual dhe bëjnë lidhjen e kopshtit me komunitetin e gjerë. Fëmijët nëpërmjet vizitës në teatër, në ambiente kulturore dhe arti, në muze, si dhe me shfaqjet që jepen në ambientin e kopshtit, vijnë në kontakt me vepra të vlerave kulturore dhe mësojnë për botën rreth tyre.



Shëtitjet edukative kanë qëllim aq sa argëtues, aq dhe pedagogjik e formues. Gjithashtu zbatohen brenda orarit të kopshtit dhe bashkërenditen me programin e tij. Pjesëmarrja e fëmijëve tuaj në shëtitjet edukative të kopshtit nuk është e detyrueshme. Gjithashtu për çdo shëtitje në veçanti nevojitet miratimi juaj me shkrim. Për sa fëmijë nuk marrin pjesë, atë ditë qëndrojnë në shtëpi.

Ç'ndodh kur në një grup ka shumë fëmijë që nuk flasin të njëjtën gjuhë?

Shumë gjuhët në një grup nuk janë problem për askënd. Gjuha e përbashkët është greqishtja dhe mësohet shumë shpejt nga fëmijët e kësaj moshe. Brenda në një grup shumëgjuhësh fëmijët mësojnë mënyra shkrimi në gjuhë të ndryshme dhe gjejnë ngjashmëritë dhe ndryshimet, njihen më mirë me kodin zyrtar gjuhësor. Bashkëzistenca e shumë gjuhëve dhe kombësive në një grup krijon një realitet shumë interesant që mobilizon grupin në eksplorime të reja. Të gjithë fëmijët përfitojnë shumë, sepse u jepet rasti të vijnë në kontakt me elementë të kulturave të tjera. Mësojnë të përballen me të ndryshmen si pasuri dhe jo si pengesë duke zhvilluar shumë aftësitë komunikuese të tyre.